

Kushte dhe Afate të përgjithshme

“Vodafone MORE”

Vodafone Albania Sh.A (Vodafone ose Ne, VFAL përkatësisht) është një shoqëri aksionere e themeluar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr. 25766, datë 10 Maj 2001, me seli në: Autostrada Tiranë-Durrës, Rr. “Pavarësia”, Nr. 61, Kashar, Tiranë, Shqipëri, me Nipt: K11715005L.

Këto Kushte dhe Afate përbëjnë të gjithë Marrëveshjen ndërmjet Jush, klient i Vodafone dhe Vodafone, në lidhje me përfitimet e dhuratave nga palët e treta bashkëpunëtoare nëpërmjet Promocionit “Vodafone MORE”, ekskluzivisht në aplikacionin My Vodafone dhe aplikacionin JUTH. Përfitimi i dhuratave të promocionit, nëpërmjet menu-së së dedikuar në aplikacionin My Vodafone dhe aplikacionin JUTH, është i mundur të bëhet vetëm pas respektimit të kushteve dhe afateve si më poshtë.

1. Cfarë është Vodafone MORE?

Është programi që shpërblen të gjithë klientët e Vodafone, bazuar në vitet që ato janë pjesë e Vodafone. Programi u ofron klientëve surpriza të përshtatura sipas nevojave, dhe një katalog të gjerë me oferta ekskluzive vetëm për klientët Vodafone.

2. Kushtet e Përgjithshme për pjesëmarrjen në “Vodafone MORE”

2.1 Të gjithë pajtimtarët ekzistues apo të rinj me parapagesë dhe me kontratë VODAFONE (më poshtë referuar si Pajtimtari) që kanë kryer regjistrimin në Vodafone me plotësimin e formularit të regjistrimit, kanë të drejtë të marrin pjesë në “Vodafone MORE”.

2.2 Regjistrimi në “Vodafone MORE” është automatik dhe fillon me aktivizimin e numrit Vodafone. Pajtimtari që ka më shumë se një numr SIM, mund të jenë pjesë disa herë e programit (aq sa SIM-e posedon), duke kuptuar se përfitimet do të ndahen në secilin prej SIM-eve dhe nuk kombinohen me njëri-tjetrin.

a) Nëse Pajtimtari me kontratë ka një detyrim kundrejt Vodafone, përfitimet e Vodafone MORE do t'i pezullohen deri në momentin kur Pajtimtari të shlyejë këto detyrime kontraktuale.

2.3 Pajtimtari do të përfitojë Vcoins në “Vodafone MORE” pas kryerjes së një ose më shumë prej veprimeve të mëposhtme, bazuar dhe në vjetërsinë e klientit:

- a) Nëpërmjet rimbushjeve të kryera me karta rimbushëse ose me anë të rimbushjeve elektronike E- Top Up;
- b) Nëpërmjet blerjes së paketave që ofrohen nga Vodafone
- c) Nëpërmjet aktiviteteve promocionale që kryhen brenda aplikacioneve të Vodafone
- d) Nëpërmjet pagesës së detyrimeve kontraktuale (për Pajtimtarët me paspagesë).

2.4 Vcoins është njësi shkëmbimi, e cila shërben për transaksione të ndryshme në dy aplikacionet tona My Vodafone dhe JUTH. Vcoins përfitohen sipas mënyrave të përcaktuara më lart në 2.3 dhe shkëmbehet në mënyrat dhe dhuratat e përcaktuara në paragrafin 4.

2.5 Regjistrimi paraprak i Programit do të lejojë që Pajtimtari, siç identifikohen automatikisht nga SIM përkatësisht Vodafone SIM, të grumbullojë Vcoins të vlefshme për shkëmbimin e një ose më shumë kuponave. Pajtimtarët e regjistruar në “Vodafone MORE” do të përfitojnë Vcoins mbas çdo eventit të përmendur më lart tek 2.3 me fashat e mëposhtme të vjetërsisë:

a) SIM me parapagesë:

Vjetërsia	Vlera	Rimbushje	Blerje pakete
<3 vite	100 lekë	2 VCoins	20 VCoins
3 – 7 vite	100 lekë	3 VCoins	30 VCoins
>7 vite	100 lekë	4 VCoins	40 VCoins

b) Sim me paspagesë planet Next

Vjetërsia	Vlera	Pagesë fature	Blerje pakete
<3 vite	100 lekë	30 VCoins	30 VCoins
3 – 7 vite	100 lekë	50 VCoins	50 VCoins
>7 vite	100 lekë	60 VCoins	60 VCoins

c) Sim me paspagesë individë

Vjetërsia	Pagesë	VCoins
<3 vite	100 lekë	30 VCoins
3 – 7 vite	100 lekë	50 VCoins
>7 vite	100 lekë	60 VCoins

d) Sim me paspagesë (person juridik)

Pajtimtarët me paspagesë person juridik do të mund të marrin benefitet e skemës pa patur nevojën e mbledhjes së Vcoins.

2.6 Vodafone rezervon të drejtën, gjatë periudhës së promovimit, të sigurojë mekanizma për të përshpejtuar akumulimin e Vcoins; këta mekanizma do të bazohen në kritere të tilla që të ofrojnë trajtim të barabartë në mesin e Pajtimtarëve me të njëjtat karakteristika kontraktuale dhe me shërbimet Vodafone; çdo përparësi e tillë do të komunikohet në:

1. Aplikacionet My Vodafone dhe JUTH
2. Faqen zyrtare të Vodafone www.vodafone.al ose www.juth.al

2.7 Vlerat në Lekë të përmendura në këto Kushte të Përgjithshme përfshijnë TVSH.

3. Mënyra e mbledhjes së pikëve në “Vodafone MORE”

3.1 VODAFONE do t'i akordojë automatikisht VCoins pajtimtarit sipas përcaktimeve në pikat 2.3 dhe 2.4 më lart të këtyre Kushteve të Përgjithshme.

3.2 Pajtimtari mund të informohet mbi totalin e akumuluar në kohë reale në My Vodafone app ose në JUTH app.

3.3 Nëpërmjet “Vodafone MORE”, VODAFONE do të shpërblejë pajtimtarin me Vcoins, vetëm në numrin e tij përkatës, për veprimet e kryera nga pajtimtari të përcaktuara në pikat 2.3 dhe 2.4 si më lart. Në rastet kur pajtimtari ka më shumë se një numër VODAFONE, pikët e fituara nga çdo numër i veçantë nuk do të mbledhen, dhe në asnjë rrethanë pajtimtari nuk do të shpërblehet në total. Çdo numër VODAFONE mban Vcoins respektive.

3.4 Në rastet kur pajtimtari ndërron numrin e tij celular dhe kalon nga pajtimtar me parapagesë në pajtimtar me paspagesë individ pikët e akumuluar do të transferohen.

3.5 Në rastet kur pajtimtari ndërron numrin e tij celular dhe kalon nga pajtimtar me parapagesë/paspagesë individ në pajtimtar me paspagesë juridik pikët e akumuluar nuk do të transferohen.

3.6 Në rastet kur një numër transferohet nga një pajtimtar VODAFONE në një pajtimtar tjetër VODAFONE, Vcoins e fituara në numrin celular të mëparshëm nuk i transferohen në asnjë rrethanë pajtimtarit të ri.

3.7 Në rast se ofrimi i shërbimeve të telefonisë publike të lëvizshme të VODAFONE ndërpritet si pasojë e veprimeve të pajtimtarit, të gjitha Vcoins e mbledhura do të fshihen menjëherë pas ndërprerjes së shërbimeve.

3.8 VODAFONE ka të drejtë të shtojë Vcoins në numrin e Pajtimtarit të regjistruar në “Vodafone MORE” për qëllime promovionale.

4. Dhuratat që do të përfitohen

4.1 Kuponat e ofruara nga VODAFONE si dhe pikët përkatëse që duhen për t'i përfituar ato janë të specifikuar në Tabelën 1 dhe 2 si më poshtë:

Katalogu momental:

1. Pajtimtarë me parapagesë dhe me paspagesë individë

Partneri	Oferta	VCoins
Mon Cheri	Bli një kafe dhe merr të dytën falas. Promocioni është i vlefshëm vetëm për kafe, makiato dhe kapuçino.	100
Yougurteria	Për çdo dy yogurt të blerë, ti paguan 100 lekë më pak. Përfito vasketën e madhe me yogurt me shijet që ti dëshiron për 1.000 lekë dhe jo për 1.500 lekë.	100
Ar&Lo	Përfito 50 Euro ulje ekskluzive në paketat turistike mbi 1.500 Euro.	100
Discover Albania	Përfito 10% ulje në vlerën totale të çdo udhëtimi.	100
Discover Albania	Përfito 10% ulje në vlerën totale të çdo udhëtimi.	200
Jona Travel	Përfito 10% ulje në vlerën totale të çdo udhëtimi.	500
Jona Travel	10% ulje për çdo hotel dhe paketë të publikuar nga agjensia.	100
Adrion	Përfito 10 Euro ulje në biletat e publikuara nga agjensia.	200
Albagame	10% ulje në faturën totale.	600
Cineplexx	10% ulje në faturën totale, promocioni përfshin të gjithë produktet përveç Konsole (si prsh XBOX) si dhe transportin falas në të gjithë Shqipërinë.	150
Cineplexx - 2	Paguaj 1 biletë dhe merr të dytën falas cdo ditë të javës, duke përjashtuar pre-premierat dhe vendet VIP.	650
Light Strike	Përfitoni një Popcorn dhe Pepsi Menu për vetëm 400 lekë.	350
BodyCode	Një lojë falas vetëm për ty.	500
	Përfito 10% ulje në abonimin 3 mujor.	600

BodyCode	Përfito 10% ulje në abonimin 6 mujor.	1000
Globe	Përfito 10% ulje në abonimin 12 mujor. Përfito 15% ulje në Globe për produkte specifike të cilat kanë logon Vodafone.	1500 650
SPAR	Përfito 10% ulje në faturën totale për blerjet mbi 5.000 lekë në të gjitha pikat SPAR, duke përjashtuar produktet që janë në ofertë.	250
Merr Taxi	Përfito 100 lekë ulje nëse udhëtimi kushton mbi 500 leke. Telefono në 08005555.	100
VODAFONE	Përfito 2GB të vlefshme për 7 ditë.	4000
VODAFONE	Përfito 1GB e vlefshme për 7 ditë.	3000
Kolonat	Përfito 300 minuta të vlefshme për 7 ditë. Përfito 10% ulje në faturën totale.	4500 200
Patinazh	Paguaj 1 merr të dytën falas çdo ditë të javës pranë Ring Center.	200
Kinema 7D	Paguaj 1 merr të dytën falas çdo ditë të javës pranë Ring Center.	200
Fit Express	Përfito 20% ulje abonimin 3 mujor në Fit Express pranë Ring Center.	600
Fit Express	Përfito 20% ulje abonimin 6 mujor në Fit Express pranë Ring Center.	1000
Fit Express	Përfito 20% ulje abonimin 12 mujor në Fit Express pranë Ring Center.	1500
Intersig	Përfito 10% ulje në sigurimin e detyrueshëm i mjeteve motorrike (TPL).	500
Intersig Max Optika	Përfito 20% ulje në sigurimin KASKO te automjeteve.	1000
	Përfito 20% ulje në sigurimin e shëndetit në udhëtim.	250
	Përfito 20% ulje në sigurimin e pronës.	500
	Përfito 10% ulje në sigurimin e aksidenteve personale.	500
Krociere	Përfito 20% ulje në faturën totale.	1500
Krociere	Përfito 350 euro ulje në udhëtimin tënd të rradhës. Vlera totale e udhëtimit duhet të jetë të paktën 1.500 euro.	-
Krociere Poligon	Përfito 150 euro ulje në udhëtimin tënd të rradhës. Vlera totale e udhëtimit duhet të jetë të paktën 1.500 euro. Përfito tarifën e regjistrimit falas.	750 200
Poligon	Përfito 40% ulje në çdo gjuajtje.	200

2. Pajtimtarë me paspagesë (person juridik)

Partneri	Oferta
Mon Cheri	Bli një kafe dhe merr të dytën falas. Promocioni është i vlefshëm vetëm për kafe, makiato dhe kapuçino.
Yougurteria	Për çdo dy yogurt të blerë, ti paguan 100 lekë më pak. Përfito vasketën e madhe me yogurt me shijet që ti dëshiron për 1.000 lekë dhe jo për 1.500 lekë.
Ar&Lo Discover Albania	Përfito 50 Euro ulje ekskluzive në paketat turistike mbi 1.500 Euro. Përfito 10% ulje në vlerën totale të çdo udhëtimi.
Jona Travel	10% ulje për çdo hotel dhe paketë të publikuar nga agjensia.

Jona Travel Adrion	Përfito 10 Euro ulje në biletat e publikuara nga agjensia. 10% ulje në faturën totale.
Albage	10% ulje në faturën totale, promovioni përfshin të gjithë produktet përveç Konsole (si prsh XBOX) si dhe transportin falas në të gjithë Shqipërinë.
Cineplexx Cineplexx - 2	Paguaj 1 biletë dhe merr të dytën falas cdo ditë të javës, duke përjashtuar pre-premierat dhe vendet VIP.
Light Strike BodyCode	Përfitoni një Popcorn dhe Pepsi Menu për vetëm 400 lekë. Një lojë falas vetëm për ty.
BodyCode Globe	Përfito 10% ulje në abonimin 3 mujor. Përfito 10% ulje në abonimin 6 mujor. Përfito 10% ulje në abonimin 12 mujor.
SPAR Merr Taxi VODAFONE	Përfito 15% ulje në Globe për produkte specifike të cilat kanë logon Vodafone. Përfito 10% ulje në faturën totale për blerjet mbi 5.000 lekë në të gjitha pikat SPAR, duke përjashtuar produktet që janë në ofertë.
VODAFONE Kolonat	Përfito 100 lekë ulje nëse udhëtimi kushton mbi 500 leke. Telefono në 08005555. Përfito 2GB të vlefshme për 7 ditë. Përfito 1GB e vlefshme për 7 ditë. Përfito 300 minuta të vlefshme për 7 ditë.
Patinazh Kinema 7D Fit Express Fit Express Fit Express Intersig	Përfito 10% ulje në faturën totale. Paguaj 1 merr të dytën falas çdo ditë të javës pranë Ring Center. Paguaj 1 merr të dytën falas çdo ditë të javës pranë Ring Center. Përfito 20% ulje abonimin 3 mujor në Fit Express pranë Ring Center. Përfito 20% ulje abonimin 6 mujor në Fit Express pranë Ring Center. Përfito 20% ulje abonimin 12 mujor në Fit Express pranë Ring Center. Përfito 10% ulje në sigurimin e detyrueshëm i mjeteve motorrike (TPL).
Intersig Max Optika	Përfito 20% ulje në sigurimin KASKO te automjeteve. Përfito 20% ulje në sigurimin e shëndetit në udhëtim. Përfito 20% ulje në sigurimin e pronës. Përfito 10% ulje në sigurimin e aksidenteve personale.
Krociere	Përfito 20% ulje në faturën totale. Përfito 350 euro ulje në udhëtimin tënd të rradhës. Vlera totale e udhëtimit duhet të jetë të paktën 1.500 euro.
Krociere Poligon	Përfito 150 euro ulje në udhëtimin tënd të rradhës. Vlera totale e udhëtimit duhet të jetë të paktën 1.500 euro. Përfito tarifën e regjistrimit falas.
Poligon	Përfito 40% ulje në çdo gjuajtje.

Pajtimtarët me paspagesë (person juridik) do të kenë mundësinë të përdorin kuponat e përmendur në tabelën 2, cdo fillim muaji kalendarik, një herë në muaj.

4.2 Pajtimtarët mund ta marrin këtë informacion edhe nëpërmjet materialeve publicitare të "Vodafone

MORE”, në seksionin e “Vodafone MORE” në faqen zyrtare të VODAFONE në internet: <http://www.vodafone.al>, si edhe në aplikacionet My Vodafone ose JUTH.

4.3 Vodafone ka të drejtë të përditësojë listën e dhuratave në mënyrë të vazhdueshme. Informacion më të detajuar mbi “Vodafone MORE” si dhe mbi Kushtet e Përgjithshme të zbatuara mund t’i gjeni duke vizituar www.vodafone.al.

5. Marrja e dhuratave

5.1 Në varësi të Vcoins të akumuluar, Pajtimtari mund të zgjedhë një prej kuponave të ofruara nga “Vodafone MORE”. Për marrjen e secilit prej kuponave të listuara si më sipër Pajtimtari duhet të ketë akumuluar Vcoins që i korrespondojnë kuponit përkatës.

Katalogu do të përmbajë kuponat, me datat përkatëse të vlefshmërisë, dhe identifikon kuponat e disponueshme në bazë të Vcoins, që do të grumbullohen me metodat e detajuara më lart.

5.2 Për çdo palë të tretë, klientët do marrin një kod promocional, në formatin alfanumerik ose dixhital (QR code).

5.3 Vlefshmëria e çdo kodi promocional është i përcaktuar vizualisht dukshëm në aplikacion.

5.4 Klientët, me qëllim përfitimin e promocionit, duhet të paraqesin kodin promocional pranë cdo pikë përfaqësuese të palëve të treta bashkëpunëtore.

5.5 Përfaqësuesi i shitjes së palëve të treta bashkëpunëtore kontrollon vlefshmërinë e kodit promocional, dhe i ofron klientit Vodafone zbritjen/ofertën përkatëse.

5.6 Në momentin e përdorimit të kodit, pajtimtarit i zbriten nga balanca e tij e Vcoins aq Vcoins sa është vlera e kuponit, në kohë reale.

5.7 Përditësimi i kuponave do të zhvillohet në një periudhë kohore jo më pak se dy muaj nga përditësimi i fundit, pa përjashtuar opsionin, në një interval edhe më të shkurtër kohor, për të ndryshuar zgjedhjen e çmimeve në dispozicion;

5.8 Nëse pajtimtari, në bazë të pikave në dispozicion, kërkon më shumë se një kupon (deri në **5** kupona), me kusht që s’ka asnjë Papajtueshmëritë teknike ndërmjet dhënies dhe produktit / shërbimit tashmë në dispozicion, mund ti marri ato.

5.9 Procedurat për kërkimin dhe mbledhjen e shpërblimeve do të komunikohen nga Vodafone në bazë të çmimeve të ndryshme në dispozicion në aplikacionin My Vodafone ose JUTH.

5.10 Në çdo kohë gjatë periudhës së promovimit, çdo anëtar i cili ka grumbulluar një numër të Vcoins të mjaftueshme për të marrë një ose më shumë kupona të zgjedhura në Katalogun e kuponave në fuqi në momentin e zgjedhjes, do të bëjë kërkesën e tij, nga: Aplikacioni My Vodafone ose JUTH

5.11 Kuponat, mund të jenë, nga kategoritë e mëposhtme:

- Kupona dixhitale, produkte ose shërbime e ofruara nga furnizues të ndryshëm nga Vodafone (në tekstin e mëtejme, së bashku, "partner");
- Shërbime që përbëhen nga trafiku i të dhënave ose zërit Vodafone (në tekstin e mëtejme: "Shërbimet Vodafone telefonike");

5.12 Katalogu ndërmjet aplikacionit My Vodafone dhe Juth mund të kenë ndryshime ndërmjet njëri tjetrit kohë mbaskohe, për arsye promovionale. Vcoins e akumuluar mund të shkëmbehen në dhurata në secilin

prej aplikacioneve, por sasia e Vcoins është vetëm një. Pra, n.q.s. kryhet një shkëmbim Vcoins me kupon në aplikacionin JUTH, zbritja e pikëve do të reflektohet në të dy aplikacionet si JUTH dhe gjithashtu My Vodafone, dhe e anasjelltà. Ky rregull i mosdublikimit vlen për të gjithë dhuratat e tjera nëpërmjet programit MORE, me përjashtim të fushatave të përcaktuara promovionale.

6. Vlefshmëria e krediteve

6.1 Proçesi nëpërmjet të cilit pajtimtari bëhet pjesëtar i “Vodafone MORE”, përcaktohet vetëm nga VODAFONE, i cili rezervon të drejtën për të kryer çdo lloj ndryshimi.

6.2 Vcoins e përfituara nëpërmjet “Vodafone MORE” nuk mund të transferohen nga një numër Vodafone në një numër tjetër celular.

6.3 Me Vcoins e akumuluar, Pajtimtari do të përfitojë vetëm prej kuponave të përcaktuara në Tabelën 1 dhe 2 përkatësisht, si më sipër, e cila do të azhurnohet vazhdimisht nga VODAFONE në varësi të disponueshmërisë së këtyre kuponave.

6.4 Vcoins që do të përfitohen nëpërmjet “Vodafone MORE”, janë të vlefshme për dy vjet duke filluar nga data e përfitimit të tyre. Shembull: Vcoins e përfituara në 20/10/19 janë të vlefshme deri më 19/10/21. Të gjitha Vcoins e akumuluar dhe që nuk janë përdorur nga Pajtimtari gjatë periudhës së vlefshmërisë së tyre, zerohen në përfundim të afatit dy vjeçar.

7. Përjashtimi nga përgjegjësia.

VODAFONE nuk mban asnjë përgjegjësi nëse aplikimi për të përfituar një dhuratë nëpërmjet “Vodafone MORE” është bërë nga një person i paautorizuar nga pajtimtari, nëse një person i tretë ka vepruar ndryshe nga autorizimi i dhënë nga pajtimtari ose për çdo arsye tjetër.

8. Kushte Specifike

- Çdo komunikim midis pajtimtarit dhe VODAFONE përsa i përket “Vodafone MORE” do të zhvillohet sipas mënyrës së parashikuar nga VODAFONE.
- Kuponat e përcaktuar në këto Kushte të Përgjithshme janë të vlefshme dhe mund të përfitohen nëpërmjet përdorimit të Vcoins të akumuluar.
- VODAFONE rezervon të drejtën të ndryshojë në çdo kohë Kushtet e Përgjithshme duke njoftuar paraprakisht pajtimtarët me SMS ose në <http://www.vodafone.al>. brenda një afati të arsyeshëm.

9. Pranimi i Kushteve

Me regjistrimin në Vodafone pajtimtari pranon plotësisht këto Kushte të Përgjithshme.

10. Kohëzgjatja e “Vodafone MORE”

“Vodafone MORE” ka filluar prej datës 02.07.2019 dhe do të jetë i vlefshëm deri në momentin e ndërprerjes nga ana e VODAFONE me një njoftim paraprak për pajtimtarët jo më pak se 15 ditë. Ky njoftim do të bëhet me SMS apo nëpërmjet faqes zyrtare në internet të VODAFONE. Në rast të ndërprerjes nga VODAFONE të “Vodafone MORE” pajtimtarët mund të përdorin Vcoins e akumuluar sipas këtyre Kushteve të Përgjithshme, përpara afatit të deklaruar nga VODAFONE për mbylljen e “Vodafone MORE”.

11. Të Dhënat Personale

Të dhënat personale të anëtarëve të “Vodafone MORE”, përpunohen nga Vodafone në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, aktet nënligjore në zbatim të tij, Kontratën e Pajtimtarit dhe politikat e brendshme të kompanisë lidhur me privatësinë.

12. Juridiksioni – Ligji i Zbatueshëm

Çdo marrëveshje ndërmjet Vodafone dhe Pajtimtarit, kur nuk zgjidhet me mirëkuptim, do t’u paraqitet për zgjidhje gjykatave kompetente shqiptare

13. Të Ndryshme

Të gjitha kushtet e parashikuara në Kushtet e Përgjithshme të Dhënies së Shërbimeve të Telefonisë Publike të Lëvizshme për Pajtimtarin me Parapagesë të VODAFONE janë gjithashtu të zbatueshme edhe për këto Kushte të Përgjithshme.

Kushtet dhe Afatet e mësipërme mund të jenë objekt i rishikimit në cdo kohë nga Vodafone Albania Sh.A. Ju do të njoftoheni brenda një afati të arsyeshëm lidhur me këto ndryshime. Për informacion të detajuar vizitoni www.vodafone.al